

K O N K L U Z I O N

Nr.08-156/1 dt.04.02.2014

**PËR SHPALLJE TË PËRFUNDIMIT PËR SJELLJEN E PROGRAMIT
PËR PUNËN NË FUSHËN E POSEDIMIT ME TOKËN NDËRTIMORE
NË PRONËSI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË TERRITORIN E
KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2014**

160.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet përfundimi për sjelljen e programit për punën në fushën e posedimit me tokën ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë në territorin e Komunës Dibër për vitin 2014, nga Këshilli i Komunës në seancën e 10^{të} dt.31.01.2014.

KOMUNA DIBËR

Kryetari,

Ruzhdi Lata d.v.

P Ë R F U N D I M

Nr. VITI 2013 MAJ

dt. VITI 2013 MAJ

**PËR SJELLJEN E PROGRAMIT PËR PUNËN NË FUSHËN E
POSEDIMIT ME TOKËN NDËRTIMORE NË PRONËSI TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË TERRITORIN E KOMUNËS
DIBËR PËR VITIN 2014**

161.Në mbështetje të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetadministrimin lokal („Gazeta Zyrtare e RM,, nr.5/02) si dhe nenit 59 të Statutit të komunës („Kumtesa Zyrtare e Komunës,, nr 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 10^{të} datë 31.01.2014 përfundoi:

1.Këshilli i Komunës solli programin për punën në fushën e posedimit me tokën ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë në territorin e Komunës Dibër për vitin 2014.

2.Programi nga pika 1 është pjesë përbërëse e përfundimit.

3.Ky përfundim hyn në fuqi një ditë pas shpalljen në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

162.Në mbështetje të nenit 36 paragrafi 1 të Ligjit për vetadmistrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr 5/2002), nenit 89 të Ligjit për tokën ndërtimore (“Gazeta zyrtare e RM” nr 17/11, 53/11,144/12, 25/13, 137/13 dhe 163/13) si dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër (“ Kumtesa zyrtare e Komunës Dibër” nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 10^{të} dt. 31.01.2014 solli:

PROGRAM

PËR PUNËN NË FUSHËN E POSEDIMIT ME TOKËN NDËRTIMORE NË PRONËSI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2014

Hyrje

I.I Pjesa e përgjithëshme

Me sjelljen e Ligjit të ri për tokën ndërtimore (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 17/11, 53/11,144/12, 25/13, 137/13 dhe 163/13), toka ndërtimore mund të jetë në pronësi të Republikës së Maqedonisë, komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit, personave juridik dhe fizik vendas apo të huaj. Pronësia e tokës ndërtimore krijon të drejta dhe obligime. Pronësia e tokës ndërtimore përfshin dhe të drejtën për ndërtim në truallin. Vendim për përfitimin e pronësisë për tokën ndërtimore për komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qytetin e Shkupit miraton Këshilli.

Pronësia komunave u mundëson të drejtat vijuese: për ndërtim, shfrytëzim, përcjellje të së drejtës për ndërtim personave tjerë si dhe tjetërsim të tokës ndërtimore.

Me tokën ndërtimore në pronësi të RM, menaxhon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Tokën ndërtimore të dedikuar për shfrytëzim të përgjithshëm, mund ta shfrytëzojnë të gjithë personat juridik dhe fizik, komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit. Të drejtën e shfrytëzimit Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund t’ua përcjell komunave. Pronësia e tokës ndërtimore përfshin sipërfaqen e saj dhe ç’do gjë lidhur me te që ndodhet mbi apo nën sipërfaqe.

Toka ndërtimore është e mirë me interes të përgjithshëm për Republikën e Maqedonisë ndërsa rregullimi i tokës ndërtimore është me interes publik.

Toka ndërtimore mund të jetë e ndërtuar dhe e pa ndërtuar, e rregulluar dhe e parregulluar.

Toka ndërtimore e ndërtuar është tokë në të cilën është ndërtuar objekt me karakter të përhershëm dhe toka e cila shërben për shfrytëzim të rregullt të objektit në kufijtë e parcelës ndërtimore.

Toka ndërtimore e rregulluar është tokë e pajisur me infrastrukturë komunale, ndërsa toka e parregulluar është ajo në të cilën nuk ka infrastrukturë komunale.

Toka ndërtimore është tokë e cila është e planifikuar me plan urbanistik apo dokumentacion të planit urbanistik.

Parcela ndërtimore është pjesë e tokës ndërtimore kufijtë e së cilës janë të definuara me planin urbanistik apo me dokumentacion urbanistik planor dhe mund të përbëhet nga një, pjesë, apo më shumë parcela kadastrale.

Objekt me karakter të përhershëm është objekt i ndërtuar me dokumentacion, leje dhe i rregjistruar në librat publikë të patundshmërive.

Objekti me karakter të përkohshëm është objekt i vendosur me leje për vendosje deri në realizim të planit urbanistik apo dokumentacionit urbanistik. Objektet e përkohshme nuk janë pjesë e tokës ndërtimore dhe mbi bazën e tyre nuk mund të përfitohet pronësia e tokës ndërtimore.

Objekti infrastrukturor është ndërtim nëntokë dhe mbitokë për instalimet e infrastrukturës komunale.

Qarkullimi i tokës ndërtimore është i lirë.

Toka ndërtimore pronësi e Republikës së Maqedonisë mund të tjetërsohet, të jepet në shfrytëzim, koncesion apo në partneritet publik privat, të jepet në qira afatgjate apo afatshkurtër, të shkëmbehet ose në të vendosen të drejta tjera reale.

I.II Përfshirja hapsinore dhe lënda e Programit

Lënda e Programit është menaxhimi me tokën ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë e cila gjendet në territorin e Komunës Dibër, e definuar sipas organizimit territorial të Republikës së Maqedonisë, për kohën e vitit kalendarik 2014.

Që të mund të kryhet tjetërsimi, dhënia me qira e tokës ndërtimore është e nevojshme të përpunohet harta e tokës ndërtimore shtetërore në komunë, me të gjitha të dhënat numerike për të njejtën.

Faktor i rëndësishëm në këtë procedurë është dhe kategoria e planit urbanistik gjegjësisht planeve urbanistike në bazë të të cilave mund të jepet leje ndërtimi.

Gjatë realizimit të Programit vjetor parashikohet, lëndë e menaxhimit me tokën ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë do të jenë parcelat ndërtimore të cilat gjinden në territorin e Komunës Dibër.

Me këtë program janë përfshirë këto lokalitete :

1. PDU pjesë nga blloku 25 zona për qëllim speciale Gazerma “Liman Kaba „
2. PDU ndryshimi dhe plotësimi i rajonit të qytetit hyrja lindore ne Dibër.
3. PDU për lolalitetin VENEC-2, për pjesë të blokut 12, 13 dhe 14 -Dibër

I.III Bazat për përpunimin e të dhënave

Baza ligjore

Baza ligjore e Programit për menaxhim me tokën ndërtimore është Ligji për vetqeverisjen lokale neni 36 pika 1 (“ Gazeta zyrtare e RM” nr. 5/2002) neni 89 i Ligjit për tokën ndërtimore (“ Gazeta zyrtare e RM”nr. 17/11, 53/11,144/12, 25/13, 137/13 dhe 163/13) dhe neni 27 i Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës Dibër” nr 14/03).

Dokumentet bazë planore:

Dokumente të tjera të cilat janë shfrytëzuar për përpilimin e Programit janë dokumentet vijuese strategjike dhe zhvillimore të aprovuara në nivel lokal.

- Studim për zhvillimin ekonomik në Komunën Dibër për periudhën planore nga viti 2005 deri në 2020.
- Plani aksional ekologjik lokal për Komunën Dibër.
- Strategjia për zhvillim të qëndrueshëm në Komunën Dibër .
- Plani gjeneral urbanistik i qytetit Dibër për periudhën planore nga viti 2005 deri në vitin 2020.
- Plotsëim ndryshim i Planit Gjeneral për bloqet: 2, 3, 5, 6, 7, 11, 15, 16, 17, 19, 21 dhe 25 (2008-2018)
- Planet urbanistike për vendbanimet.
- Programi për përpunimin e planeve urbanistike për vitin 2013 dhe 2014
- Dokumente tjera strategjike.

I.IV. Persona të përfshirë në përpunimin e Programit.

-Petrit Paçuku inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë-Udhëheqës i sektorit për urbanizëm,mbrojtje të ambientit jetësor,zhvillim ekonomik lokal, veprimtari komunale, komunikacion dhe rrugë.

-Gazmend Cami inxhinjer arkitekt i diplomuar-Udhëheqës i Njesisë për urbanizëm, mbrojtje të ambientit jetësor dhe zhvillim ekonomik lokal.

-Durim Fetahu inxhinjer arkitekt i diplomuar, këshilltar në Njësinë për urbanizëm,mbrojtje të ambientit jetësor dhe zhvillim ekonomik lokal.

-Adraman Tozlluku jurist i diplomuar –Udhëheqës i Njesisë për punë juridike dhe të përgjithshme.

-Vlladimir Stefanovski inxhinjer i diplomuar i gjeodezisë, bashkëpunëtor i ri në Njësinë për urbanizëm,mbrojtje të ambientit jetësor dhe zhvillim ekonomik lokal,

-Osman Imetoski jurist i diplomuar këshilltar në Njesisë për punë juridike dhe të përgjithshme.

II Qëllimet e Programit

II.I- Qëllimet e përgjithshme të Programit

Sigurimi i kushteve për zhvillim socio-ekonomik të komunës nëpërmjet krijimit të kushteve hapsinore për zhvillim.


II-II-Qëllimet konkrete të Programit në vendet e banuara, blloqet urbane dhe lokalitet.

Qytetarët e interesuar për ndërtimin e hapsirave të veta për ushtrimin e veprimtarisë, mund të realizojnë nevojën e tyre e me këtë do të kontribuojnë për zhvillimin e vendbanimit/lokalitetit, shfrytëzimin e resurseve lokale, punësimin e personave, sigurimin e kushteve më të mira për jetesë.

III. Vëllimi dhe pasqyra e tokës ndërtimore që është lëndë e programit
III.I.Shtojca grafike me parcelat e shënuara që do të jenë lëndë e menaxhimit

Ekstrakt nga PDU „Hyrja Lidore” pjesë e Bllokut urban 15 , Vendim i Këshillit të Komunës nr. 07-504/4 dt.30.04.2008 Kumtesa zyrtare e Komunës nr. 31/2008

Parcelat nr. 1.2; 1.3; 1.4 и 1.5




Ekstrakt nga PDU BU 25 Zona për qëllime speciale Gazërma Liman Kaba, Vendim i Këshillit të Komunës nr. 07-218/5 dt.09.03.2010 Kumtesa zyrtare e Komunës nr. 11/2010

Parcela nr. 25.1; 25,2 ; 25.3; 25.14 i 25.15



Ekstrakt nga PDU – VENEC-2, për pjesë të blokut 12,13 dhe 14 -Dibër Vendim i Këshillit të Komunës nr. 07-1007/6 dt.20.11.2013 Kumtesa zyrtare e Komunës nr. 05/2013

Parcela nr : 14.1; 14.2 ; 14.54 dhe 14.55



III. II Pasqyra detajuese e parcelave ndërtimore sipas vendbanimit dhe sipas planit urbanistik

Nr . rr.	nr. PN	sipërfaqe	destinimi tokës	destinimi tokës përshkrim	nr. e PK në PN	sipërfaq. për ndërtim	sipërfaq. e zhvill. bruto	përqi. e ndërtimit	koeficienti i shfrytëzimit	Lartësia max e lejuar	etazhi	çmimi fillestar në m ² /den.
1	25.15	3253	B1-B6	komerciale afarist	9208/3	1952	3253	60%	1.2	8.50	P+1	1.100.00
2	25.1	2650	B1-B6	komerciale afarist	9208/4	1590	2650	60%	1.2	8.50	P+1	1.100.00
3	25.14	4091	B1-B6	komerciale afarist	9208/5	2455	4091	60%	1.2	8.50	P+1	1.100.00
4	25.2	3660	B1-B6	komerciale afarist	9208/6	2196	3660	60%	1.2	8.50	P+1	1.100.00
5	25.3	4350	B1-B6	komerciale afarist	9208/8	2610	4350	60%	1.2	8.50	P+1	1.100.00
6	1.2	1850	B3	Njësi të mëdha hoteljere	5548/1	1177	4708	64%	2.54	10.50	P+2+ Nk	1.600.00
7	1.3	2465	B3	Njësi të mëdha hoteljere	5548/1 5548/4	1606	6424	65%	2.61	10.50	P+2+ Nk	1.600.00
8	1.4	1020	B2	Qendra të mëdha tregtare	5548/1	585	2925	57%	2.87	13.50	P+3+ Nk	1.600.00
9	1.5	1980	B2	Qendra të mëdha tregtare	5548/1	542	2710	27%	1.37	13.50	P+3+ Nk	1.600.00
10	14.1	440	A1	Banim në shtëpi banimi	5557	194	776	44%	1.76	10.2	P+2+ Nk	61,00
11	14.2	450	A1	Banim në shtëpi banimi	5557	194	776	43%	1.72	10.2	P+2+ Nk	61,00
12	14.54	1440	A2	Banim në ndërtesa banimi	5538/1	700	4900	49%	3.4	19.2	P+5+ Nk	800
13	14.55	2253	A2	Banim në ndërtesa banimi	5361/5 5538/1	1200	8400	53%	3.73	19.2	P+5+ Nk	800

IV. Marketing strategjia për promovimin e tokës ndërtimore që është lëndë e këtij Programi.

Në kuadër të aktiviteteve programore të komunës Dibër në fushën e promovimit dhe komunikimit me publikun në vitin 2014 janë parapa mjete nga Buxheti i Komunës për realizimin e fushatave informative për shitjen e tokës ndërtimore.

Fushatat realizohen përmes përgatitjes së TV dhe Radio spoteve, fllaereve dhe lajmërimeve për publikun në varësi të qëllimeve dhe efekteve të planifikuara.

Në përgatitjen e fushatave merr pjesë Grupi për udhëheqje me fokus departamentin përgjegjës për çështje të veçanta. Në bazë të programit për aktivitetet e Komunës Dibër në fushën e promovimit dhe komunikimit me publikun në vitin 2014 Komuna është në përgatitje.

Në varësi nga nevojat, tema e tokës ndërtimore mund të jetë pjesë e strategjisë afatgjate dhe administrata komunale është e obliguar për implementimin e marketing strategjisë.

V. Dinamika e realizimit të Programit

Me qëlimin e zvogëlimit të shpenzimeve financiare të lidhura me publikimin e shpalljeve për tjetërsimin respektivisht dhënien me qera të tokës ndërtimore, parashihet që parcelat ndërtimore që janë lëndë e Programës vjetore të publikohen në turnuse.

Çdo etapë do të përmbledh publikimet e konkurseve të parcelave ndërtimore që gjenden në përbërje të vendeve të caktuara urbane, blloqe dhe lokalitete. Në tremujorin e fundit të vitit 2012 do të publikohen parcelat ndërtimore të përfshira në programin dhe atë në përputhje me qëllimin e tokës dhe lokalitetin.

Me publikimin do të përcaktohen, vendosen parametrat në vijim: lartësia e depozitit për pjesëmarrje, vendosja e faqes së internetit ku do bëhet ankandi, përcaktimi i kushteve për pjesëmarrje, përshkrimi i detyrimeve tjera dhe dhënia e informacione tjera relevante në lidhje me këtë çështje.

Persona kompetent për realizimin e Programit

Petrit Paçuku inxh. i dipl.i ndërtimtarisë

Gazmend Cami inxh. arkitekt i diplomuar

Durim Fetahu inxh. arkitekt i diplomuar

Adraman Tozlluku jurist i diplomuar

Vladimir Stefanovski ID Gjeodet

Osman Imetosiki jurist i diplomuar

VI. Vlerësimi i fondeve të nevojshme për realizimin e Programit,

Mjetet financiare për realizimin e Programit përbëhen nga një përmbledhje e mjeteve të vlerësuara financiare të nevojshme për realizimin e aktiviteteve në vijim.

-Shpenzimet lidhur me administrimin e procedurave për tjetërsimin respektivisht dhënien me qera të tokës ndërtimore 500.000 den.

-shpenzime për promovim respektivisht reklamë të lokaliteteve tokësore të cilat do të jenë lëndë e tjetërsimit respektivisht dhënies me qera të tokës ndërtimore 200.000 den.

VII. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Programi mund të ndryshohet dhe plotësohet në mënyrën dhe procedurën e njëjtë të miratimit.

Për zbatimin e këtij programi është përgjegjës Kryetari i Komunës.

Programi hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në Kumtesën zyrtare të Komunës Dibës.

K O N K L U Z I O N
Nr.08-156/2 dt. 04.02.2014
PËR SHPALLJE TË PËRFUNDIMIT PËR SJELLJEN
E PROGRAMIT PËR PUNËN-AKTIVITETET E
NJËSTKZ -KOMUNA DIBËR PËR VITIN 2014

163.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),
Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet përfundimi për sjelljen e programit për punën-aktivitetet e NJTKZ Komuna Dibër për vitin 2014 nga Këshilli i Komunës në seancën e 10^{të} dt.31.01.2014.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

P Ë R F U N D I M
Nr.07-116/5 dt. 31.01.2014
PËR SJELLJEN E PROGRAMIT PËR
PUNËN-AKTIVITETET E NJTKZ -KOMUNA DIBËR
PËR VITIN 2014

164.Në mbështetje të nenit 36 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM”nr.5/02) dhe nenit 59 të Statutit të komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 10^{të} dt. 31.01.2014 përfundoi:

1.Këshilli i komunës Dibër sjell programin për punën-aktivitetet e NJTKZ –Komuna Dibër për vitin 2014.

2. Ky përfundim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën zyrtare të Komunës”.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

**PROGRAMI
PËR PUNËN E NJTKZ PËR VITIN 2014**

AKTIVITETET

1.Aktivitetet kryesore të Njesisë Territoriale Kundër Zjarrit janë shuarja e zjarreve, shpëtimi i jetëve të njerëzve dhe pasurisë së tyre të kërcenuara nga zjarret apo ç'fardo qoftë fatkeqësie tjetër.

Afati – Janar – Dhjetor

2.Në vitin 2014 përveç aktiviteteve themelor të NJKTZ janë planifikuar të mbahen dhe aktivitete tjera të planifikuara me qëllim që Njësia të jetë e përgatitur të përgjigjet problemeve të cilat mund të paraqiten gjatë punës . Në Njësi janë planifikuar kryerja profesionale e mësimit dhe trajnimit të zjarrëfiksive me qëllim ngritjen e nivelit të njohurive.

Afati – Janar – Dhjetor

3.Gjatë vitit 2014 janë planifikuar takime me Njësitë territorijale republikane kundër zjarrit dhe Shoqatën komunale kundër zjarrit në Dibër, si dhe mbajtja e rregullt e kontakteve me subjektet të cilat kontribuojnë dhe participojnë në mbrojtjen nga zjarret dhe fatkeqësitë e tjera natyrore .

Afati – Janar – Dhjetor

4.Kryerja e intervenimeve teknike dhe përgatitja e Njesisë për atë qëllim. Sipas paisjeve teknike dhe plotësimit kadrovik të Njesisë do të përgjigjet në të gjitha interevenimet të cilat do të kërkohen.

Afati – Janar – Dhjetor

5. Analiza e zjarreve të mëdha të cilat i ka shuar NJTKZ në 2013.

Në kohën e planifikuar për mësime dhe trajnim të të punësuarve planifikohet që të bëhet pasqyra e zjarreve në të cilat ka intervenuar Njësia, me qëllim që në momentin e dhënë përvoja të shfrytëzohet për ballafaqim me të lehtë dhe të shpejtë të zjarreve. Do të merren parasysh, paraqitja teknike, veprimi taktik, mënyra e shuarjes së zjarreve, strategjia si dhe mangësitë dhe gabimet me të cilat është ballafaquar Njësia.

Afati – Janar – Dhjetor

6. Aftësimi dhe përkryerja profesionale e të punësuarve në Njësi.

Në bazë të Planit të përgatitur për kryerjen e mësimit profesional dhe trajnim për vitin 2014, aftësimi dhe trajnimi i të punësuarve në Njësi këtë vit merr vend prioritar në aktivitetet e planifikuara të Njesisë, me qëllim që të bëhet trajnimi i të punësuarit në Njësinë kundërzjarrit .

Nr.10/04.02.2014 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq. 295

Në bashkëpunim me Florijan të Anglisë në muajin Maj do të mbahet trajnim i të punësuarve në NJTKZ me zgjatje nga 10 deri 25 maj. Trajnimin në tërësi do zbatojnë instruktorët nga operacioni Florian .

Afati – Janar – Dhjetor

7. Bashkëpunimi i Njesisë Territoriale Kundër Zjarrit

Bashkëpunimi i nevojshëm i Njesisë Territoriale Kundër Zjarrit, me Ndërmarrjet të cilat udhëheqin me pyjet , Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim dhe Qendrën për ballafaqim me krizat si dhe subjekte te tjera.

Afati: Janar- dhjetor

8. Përgatitja e njesisë për sesonin verë gjegjësisht dimër .

Përgatitja e makinave për njërin gjegjësisht sezonin tjetër, karakterizohet me paisjen e makinave me një gjegjësisht tjetër paisje, por në asnjë rast jo më pak se e përshkruar në Rregulloren për paisje minimale dhe mjete për shuarjen e zjarrit.

Afat: Prill-Tetor

9. Servisimi i paisjeve dhe aparateve kundër zjarrit

Servisimi i aparateve, paisjeve dhe mjeteve për shuarjen e zjarreve me të cilat disponon Njësia planifikohet sipas Rregullores për paisje minimale dhe mjete për shuarjen e zjarreve të përshkruara nga Drejtori i drejtorise për Mbrojtje dhe Shpëtim. Mjetet për këtë mirëmbajtje janë të siguruara nga ana e Komunës.

Afati – Janar – Dhjetor

10. Mbajtja e evidencës së paraparë

Për evidentimin e gjendjes, intervenimet, ngjarjet dhe aktivitetet e tjera të cilat i ka ndërmarrë Njësia mban libra evidentues si më poshtë:

- libër për kujdestari të vazhdueshme
- libër për ndodhitë e ditës
- libër për evidentimin e zjarreve
- paraqitja e zjarreve
- udhëzues për punën e Njesisë
- udhëzues për ndërimin e turnit
- udhëzues për shqyrtim ditor dhe javor të makinave

11. Përveç aktiviteteteve të përmendura Njësia Territoriale do të angazhohet edhe me aktivitete të tjera të cilat do dalin gjatë punës së Njesisë, të theksojmë se me plotësimin kadrovik të Njesisë, ajo pret rezultate me të mira me ballafaqimet me zjarret dhe intervencat tjera në të cilën do të përgjigjet gjatë vitit 2014.

**Nr.07-116/6
31.01.2014
Dibër**

**KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.**

K O N K L U Z I O N
Nr.08-156/3 dt. 04.02.2014
PËR SHPALLJE TË PËRFUNDIMIT PËR SJELLJEN
E PLANIT PËR ZBATIMIN E MËSIMIT DHE TRAJNIMIT
PROFESIONAL TË TË PUNËSUARVE NË NJTKZ- KOMUNA DIBËR
PËR VITIN 2014

165.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet përfundimi për sjelljen e Planin për zbatimin e mësimit dhe trajnimit profesional të të punësuarve në NJTKZ –Komuna Dibër për vitin 2014 nga Këshilli i Komunës në seancën e 10^{të} dt.31.01.2014.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

P Ë R F U N D I M
Nr.07-116/7 dt. 31.01.2014
PËR SJELLJEN E PLANIT PËR ZBATIMIN E MËSIMIT DHE
TRAJNIMIT PROFESIONAL TË TË PUNËSUARVE NË NJTKZ-
KOMUNA DIBËR PËR VITIN 2014

166.Në mbështetje të nenit 36 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM”nr.5/02) dhe nenit 59 të Statutit të komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 10^{të} dt. 31.01.2014 përfundoi:

1.Këshilli i komunës Dibër sjell Planin për zbatimin e mësimit dhe trajnimit profesional të të punësuarve në NJTKZ –Komuna Dibër për vitin 2014.

2. Ky përfundim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën zyrtare të Komunës”.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

P L A N I

Për zbatimin e mësimit dhe trajnimit profesional të të punësuarve në Njësinë Territoriale Kundër Zjarrit në Komunën Dibër për vitin 2014.

Pika 1

Përkryerja profesionale e të punësuarve në NJTKZ do të kryhet sipas Rregullores për aftësim dhe përkryerje profesionale të të punësuarve në NJTKZ e miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme konform nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizim të administratës shtetërore (“ Gazeta zyrtare e RM” nr 58/2000).

Pika 2

Me këtë plan vërtetohet numri dhe lloji i lëndëve mësimore, fondi i orëve mësimore për lëndë, orari i temave mësimore për lëndë, koha e zbatimit mësimor, përcakimi i gradave të të punësuarve për rezultatin e aritur , mbajtja e evidencës dhe raporteve të dërguara për realizimin e mësimit dhe trajnimit.

Pika 3

Mësimi do të realizohet në periudhën prej vitit 01.01.2014 deri më 31.12.2014. Mësimi do të kryhet cdo ditë pune nga 3 deri në 4 orë mësimore. Mësimi nuk do të kryhet në festat shtetërore , ditën e shtunë dhe të diel, gjatë kohës së intervenimeve ndërsa orët në këtë periudhë do të plotësohn mbahen më vonë.

Pika 4

Mësimi do të kryhet sipa lëndëve mësimore dhe sipas orëve të planifikuara mësimore vijuese

Lëndët mësimore	Fondi i orëve	Tremujori			Tremujori			Tremujori		
		1	2	3	1	2	3	1	2	3
Rregullat	8	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Preventive	17	1	2	2	2	2	2	2	2	2
Paisjet përgatitore	45	5	5	5	5	5	5	5	5	5
Taktika	38	4	4	4	4	4	5	5	5	5
Ushtrime taktike	8	0	1	1	1	1	1	1	1	1
Ushtrime praktike	60	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	40	4	5	4	5	5	4	4	5	5
Ndihma e parë	10	2	1	1	1	1	1	1	1	1
Përgatita fizike	40	5	4	5	5	4	4	5	4	4
Gjithsej		23	23	23	24	22	24	24	24	24

Pika 5

Orët nga lënda mësimore ushtrime praktike do të mbahen në muajin korrik, gusht edhe shtator sipas udhëzimeve për kryerjen e ushtrimeve praktike .Krahas këtij udhëzimi do të shfrytëzhet edhe literature tjetër me të cilën disponon Njësia me qëllim të ngritjen së nivelit të njohurive të të punësuarve në Njësi. Për kryerjen e ushtrimeve praktike rol të rëndësishëm kanë paisjet dhe mjetet me të cilat disponon Njësia.

Pika 6

Gjatë periudhës mësimore do të kryhen 8 ushtrime taktike. Ushtrimet taktike të planifikuara do të ndahen në dy pjesë dhe atë

- a)Ushtrimet taktike që do të zhvillohen në Njësi .
- b)Ushtrimet taktike te cilat do të zhvillohen jashtë Njesisë

Ushtrimet taktike te cilat do të zhvillohen jashtë Njesisë do të zhvillohen në tremujorin e tretë dhe planifikohen të zhvillohen në organizata më të mëdheja të Komunës sonë.

Pika 7

Mësimi i planifikuar në këtë plan do zhvillojë komandanti i Njesisë territoriale kundërzjarrit ndërsa në mungesë të tij zjarfiksi i emëruar prej tij.

Pika 8

Realizimi i mësimit dhe trajnimit në bazë të Planit do të evidentohet në libër të veçantë për evidentimin e mësimit dhe trajnimit të zhvilluar. Në evidencën theksohet zbatuesi i mësimit, tema, lënda mësimore dhe të pranishmit në mësim .

Pika 9

Pas kryerjes së mësimit tremujor, do të zhvillohet testimi për të verifikuar zotërimin e materialit. Materiali i pa zotëruar nga lënda e caktuar do të përsëritet me planin mujor për mësim dhe trajnim për tremujorin e ardhshëm që e njëjta të jetë tërësisht e zotëruar.

Pika 10

Ky Plan hyn në fuqi nga 01.01.2014 dhe do të realizohet deri më 31.12.2014.

**Nr.07-116/8
31.01.2014
Dibër**

**KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.**

K O N K L U Z I O N
Nr.08-156/4 dt. 04.02.2014
PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR VERIFIKIMIN E
PROJEKTPLANIT DETAL URBANISTIK PËR PJESË
TË BLOKUT 7 dhe PJESË TË BLOKUT 22 -DIBËR

167.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),
Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për verifikimin e Projektplanit Detal Urbanistik për pjesë të Bllokut 7 dhe pjesë të Bllokut 22 Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 10^{të} dt.31.01.2014.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M
Nr. 07-116/9 dt. 31.01.2014
PËR VERIFIKIMIN E PROJEKTPLANIT
DETAL URBANISTIK PËR PJESË
TË BLOKUT 7 dhe PJESË TË BLOKUT 22 -DIBËR

168.Në mbështetje të nenit 24 paragrafi 2 të Ligjit për planifikim hapsinor dhe urbanistik (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 51/05, 137/07, 91/09, 124/10, 18/11, 53/11, 144/12, 55/13 dhe 163/13), Programin për plotësimin e Programit vjetor për përgatitjen e planeve urbanistike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2013 (“Kumtesa zyrtare e Komunës Dibër” nr. 4/13) si dhe nenit 90 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare “ nr. 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 10^{të} dt. 31.01.2014 vendosi:

Neni 1

Verifikohet PROJEKTPLANI DETAL URBANISTIK PËR PJESË TË BLOKUT 7 dhe PJESË TË BLOKUT 22 -DIBËR me sipërfaqe prej 13.3 ha me këta kufinj: veri rr. “Xhavit Ushtelenca “, perëndim rr. “Korpusi 15”, jug- rr. “Eqerem Zengo” dhe lindje rr. Zeqir Çanka” dhe rr. e “Partizanit”

Neni 2

Projektplani Detal urbanistik me numër teknik 26/13 është i punuar nga POLOGPROEKT-PRO SHPK GOSTIVAR dhe përmban pjesën tekstuale dhe grafike që janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 3

Lidhur me Projektplanin Detal Urbanistik do të organizohet prezentim dhe anketë publike konform dispozitave të Ligjit për Planifikim hapsinor dhe urbanistik.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën zyrtare të Komunës Dibër”

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08-156/5 dt. 04.02.2014
PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR PLOTËSIM TË
VENDIMIT PËR REALIZIMIN E
BUXHETIT TË KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2014

169.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),
Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për plotësim të vendimit për realizimin e Buxhetit të Komunës Dibër për vitin 2014, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 10^{të} dt.31.01.2014.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M
Nr.07-116/10 dt. 31.01.2014
PËR PLOTËSIM TË
VENDIMIT PËR REALIZIMIN E
BUXHETIT TË KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2014

170.Në mbështetje të nenit 36 paragrafi 1, pika 2 të Ligjit për vetqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e RM”nr.5/02), nenit 23 paragrafi 8 të Ligjit për financimin e Njësive të vetadministrimit lokal (“Gazeta zyrtare e RM”nr. 61/2004, 96/2004, 67/2007 156/2009 dhe 47/2011) si dhe nenit 27 paragrafi 1 pika 4 të Statutit të Komunës (“Kumtesa zyrtare e Komunës” nr. 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 10^{të} dt. 31.01.2014 vendosi:

Neni 1

Në vendimin për realizimin e buxhetit të Komunës Dibër për vitin 2014 miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 9 dt. 25 dhjetor 2013 me nr. 07-1171/5 shpallur në “Kumtesën zyrtare të Komunës” nr. 9/2013, në nenin 6 në reshtin e dytë pas numrit “73.8” denarë në vazhdim shtohet ky tekst:

-“për periudhën nga 01.01.2014 deri më 30.09.2014 ndërsa 77.5 denarë për periudhën nga 01.10.2014 deri më 31.12.2014”

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi me ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën zyrtare të Komunës Dibër” .

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08-156/6 dt. 04.02.2014
PËR SHPALLJE TË PËRFUNDIMIT
PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR REALIZIMIN E BUXHETIT TË
KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2013-KUARTALI I KATËRT

171.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet përfundimi për miratimin e raportit për realizimin e Buxhetit të Komunës Dibër për vitin 2013-kuartali i IV, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 10^{të} dt.31.01.2014.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

P Ë R F U N D I M
Nr. 07-116/11 dt. 31.01.2014
PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR REALIZIMIN E BUXHETIT TË
KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2013-KUARTALI I KATËRT

172.Në mbështetje të nenit 32 paragrafi 2 të Ligjit për financimin e njërive të vetadministrimit lokal („Gazeta zyrtare e RM,, nr. 61/2004, 96/2004, 67/2007 dhe 156/2009),), nenit 36 paragrafi 1 pika 7 të Ligjit për vetadministrimin lokal („Gazeta zyrtare e RM,, nr.5/02) si dhe nenit 59 të Statutit të komunës („Kumtesa zyrtare e Komunës,, nr 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 10^{të} datë 31.01.2014 përfundoi:

1.Këshilli i Komunës Dibër miraton raportin për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2013 –Kuartali i katërt.

2.Raporti për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2013 –Kuartali i katërt është pjesë përbërëse e përfundimit.

3.Ky përfundim hyn në fuqi ditën e tetë nga shpallja në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

KËSHILLI I KOM UNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08-156/7 dt. 04.02.2014
PËR SHPALLJE TË PËRFUNDIMIT
PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT
VJETOR PËR NDËRTIM, RINDËRTIM, REHABILITIM,
MIRËMBAJTJE DHE MBROJTJE TË RRUGËVE KOMUNALE DHE
RRUGICAVE NË KOMUNËN E DIBRËS PËR v. 2013

173.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibrë (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),
Kryetari i Komunës Dibrë:

K o n k l u d o i

Shpallet përfundimi për miratimin e raportit për realizimin e programit vjetor për ndërtim, rindërtim, rehabilitim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve komunale dhe rrugicave në Komunën e Dibrës për vitin 2013, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 10^{të} dt.31.01.2014.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

P Ë R F U N D I M

Nr. 07-116/12 dt. 31.01.2014

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT
VJETOR PËR NDËRTIM, RINDËRTIM, REHABILITIM,
MIRËMBAJTJE DHE MBROJTJE TË RRUGËVE KOMUNALE DHE
RRUGICAVE NË KOMUNËN E DIBRËS PËR v. 2013**

174.Në mbështetje të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM “ nr. 05/2002) si dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibrë (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),
Këshilli i Komunës Dibrë në seancën e 10^{të} dt. .2014 përfundoi:

1. Këshilli i Komunës Dibrë miraton raportin për realizimin e programit vjetor për ndërtim, rindërtim, rehabilitim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve komunale dhe rrugicave në Komunën e Dibrës për vitin 2013.
2. Pjesë përbërëse e përfundimit është raporti nga pika 1.
3. Ky përfundim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

RAPORTI VJETOR
PËR REALIZIMIN TË PROGRAM VJETOR
PËR NDËRTIM, RIKONSTRUIM, REHABILITIM ,MIRËMBAJTJE DHE
MBROJTJE TË RRUGËVE KOMUNALE DHE RRUGICAVE NË
TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR, PËR VITIN 2013

A. BILANCI I TË ARDHURAVE:					
<i>Nr. rënd.</i>	<i>Pozicione</i>	<i>Të planifikuara</i>	<i>Të realizuara</i>	<i>(%)</i>	
	<i>Gjithsejt të ardhura:</i>	43.000.000,00	21.021.433,00	48.89	
1.	Ndërmarrja publike për rrugë shtetërore -Shkup	5.000.000,00	2.899.039,00	57.98	
2.	Participim	13.000.000,00	17.022.394,00	130.94	
3.	Agjencioni për zhvillim të barabartë në R.M.	15.000.000,00	-	0.0	
4.	Donacione	10.000.000,00	1.100.000,00	11.0	

B. BILANCI I HARXHIMEVE:					
	<i>Gjithsejt harxhime:</i>	43.000.000,00	21.021.433,00	48.89	
I. Rrugë komunale në fshatra					
1.	Rindërtim i pjesës së rrugës lokale për f. Mororçë	9.000.000,00	1.200.000,00	13.33	
2.	Ndërtimi i pjesës së rrugës për fshatin Banjisht	2.500.000,00	-	0.0	
3.	Ndërtimi i pjesës së rrugës lokale për f. Kosovrast i Poshtëm	2.000.000,00	800.000,00	40.0	
4.	Ndërtimi i pjesës së rrugës për fshatin Kosovrast i Epërm	500.000,00	-	0.0	
5.	Ndërtimi i pjesës së rrugës për fshatin Otishan	500.000,00	-	0.0	
6.	Ndërtimi i pjesës së rrugës për fshatin Zepisht	500.000,00	-	0.0	
II. Rrugë komunale dhe rrugica në qytet					
1.	Ndërtimi i rrugës “100”	2.000.000,00	3.190.778,00	159.53	
2.	Ndërtimi i pjesës së rrugës “102” (pune paraprake)	2.000.000,00	2.866.540,00	143.33	
3.	Ndërtimi i pjesës së rrugës “Ice Ristevski”	1.000.000,00	900.000,00	90.0	
4.	Asfaltimi i pjesës së rrugës “Zija Mersovski”	2.000.000,00	-	0.0	
5.	Ndërtimi i rrugës “X” (Venec-II)	2.000.000,00	-	0.0	
6.	Sanimi i pjes. së rrugës “Partizani”	1.000.000,00	-	0.0	

7.	Ndërtimi me punë paraprake të pjesës së rruges “Ali Zengovski”	3.500.000,00	2.000.000,00	57.14	
8.	Ndërtimi i rrugës “Tasa Martinovska”	3.000.000,00	2.000.000,00	66.67	
9.	Ndërtimi i rrugës “3” (Venec-2)	1.500.000,00	-	0.0	
10.	Ndërtii të rrugëve dytësore (anësore) në Dibër	5.000.000,00	6.000.000,00	120.0	
III. Mirëmbajtja dimërore në qytet dhe fshatra					
1.	Mirëmbajtja dimërore në qytet dhe fshatra	1.500.000,00	534.835,00	35.66	
IV. Shpenzime tjera					
1.	Mbushja e gropave në për rrugët në qytet dhe fshatra	2.000.000,00	1.529.280,00	76.46	
2.	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	1.000.000,00	-	47.3	
3.	Përgatitja e projekteve dhe studimi për rrugët	500.000,00	-	0.0	

- Të planifikuara..... 43.000.000,00 denar
 - Të realizuara..... 21.021.433,00 denar
Programi vjetor për 2013 u realizua: 48.89%

K O N K L U Z I O N
Nr.08-156/8 dt. 04.02.2014
PËR SHPALLJE TË PËRFUNDIMIT
PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR PUNËN E KËSHILLIT TË
KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2013
(PRILL-DHJETOR 2013)

175.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),
Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet përfundimi për miratimin e raportit për punën e Këshillit të Komunës Dibër për vitin 2013 (prill-dhjetor 2013), miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 10^{të} dt.31.01.2014.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

P Ë R F U N D I M
Nr. 07-116/13 dt. 31.01.2014
PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR PUNËN E
KËSHILLIT TË KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2013
(Prill-dhjetor 2013)

176.Në mbështetje të nenit 36 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e R.M. nr 5/2002) si dhe nenit 44 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës Dibër nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 10^ë dt. 31.01.2014 përfundoi:

1.Miratohet raporti për punën e Këshillit të Komunës Dibër për vitin 2013 (Prill-dhjetor 2013).

2.Ky përfundim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën zyrtare të Komunës Dibër”

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

R A P O R T
PËR PUNËN E KËSHILLIT TË
KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2013 (prill-dhjetor 2013)

Në vitin 2013 (mandatin e ri prill-dhjetor 2013) Këshilli i Komunës Dibër punoi në përputhje me Programin për punë të Këshillit.

Meqenëse në vitin 2013 ishin dhe zgjedhjet lokale , deri në zgjedhjet lokale Këshilli ka konvokuar dhe mbajtur 9 seanca të rregullta në të cilat ka sjellë akte të ndryshme si, Programe, vendime aktvendime, përfundime nga fusha të ndryshme nga kompetenca e saj me interes publik dhe rëndësi lokale për funksionimin e pushtetit vendor.

Të gjitha aktet e miratuara nga Këshilli i Komunës Dibër, konform ligjit janë të nënshkuarë nga Kryetari i Këshillit , të shpallura nga Kryetari i Komunës dhe të botuara në “Kumtesën zyrtare” të Komunës për ç’do seancë të Këshillit. Aktet dhe Kumtesa zyrtare përpilohet në dy gjuhë, në gjuhëm shqipe dhe gjuhën maqedonishte. Kopje e Kumtesës zyrtare me aktet e miratuara dërgohet Ministrisë respektive, kompetente, për punët e vetqeverisjes lokale.

Këshilli i komunës në përbërjen e re dalë nga zgjedhjet lokale të vitit 2013 sipas seancave ka miratuar këto akte, të paraqitura më poshtë.

Rrjedha e seancave dhe miratimi i akteve të Këshillit gjatë vitit 2013 (prill-dhjetor):

SEANCA E 1 konstituive

Nr.07-307/1 dt.12.04.2013

Në këtë seancë Këshilli miratoi:

Aktvendim për zgjedhje të komisionit verifikues
Vendim për verifikimin e mandatit anëtarëve të Këshillit të Komunës Dibër
Aktvendim për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Komunës Dibër
Aktvendim për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërimet
KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS Nr. 1

SEANCA E 2

Nr. 07-388/1 dt. 08.05.2013

Në këtë seancë Këshilli miratoi:

Aktvendim për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit për statut dhe dispozita,
Aktvendim për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit për financa, buxhet dhe zhvillim ekonomik lokal
